



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefquetndroqi.gov.al
info@sushefquetndroqi.gov.al

Tirane, me __24/03/2017__

Raport

Tema : Edukim dhe promocion ne lidhje me semundjen e Tuberkulozit ne kuader te Dites Boterore te Tuberkulozit ne dispanserine e Tiranës .

Në Ditën Ndërkombëtare të ndërgjegjësimit ndaj sëmundjes së Tuberkulozit Ministria e Shëndetësisë, Programi Kombëtar i Tuberkulozit në bashkëpunim me Zyrën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Shqipëri organizoi në mjediset e Dispancerisë së Sëmundjeve të Mushkërive në Tiranë një takim me punonjës të kujdesit shëndetësor që shërbejnë në këtë qendër. Në fokus të takimit ishte informimi, sensibilizimi dhe inkurajimi i personelit shëndetësor ndaj kësaj sëmundjeje

Gazmend Bejtja, përfaqësues i Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Shqipëri u shpreh se .“Organizata Botërore e Shëndetësisë mbështet të gjitha vendet anëtare të OBSH-së lidhur me marrjen e masave efikase për uljen e mëtejshme të rasteve të reja me tuberkuloz lidhur me suksesin e trajtimit, uljen e mëtejshme të vdekshmërisë së tuberkulozit”

Tuberkulozi është një sëmundje e cila sot kurohet me sukses. Është sëmundje e cila diagnostikohet mirë dhe në kohën e duhur. Duhet që të prekurit të shkojnë përmes të gjithë ciklit të ekzaminimeve, të marrin trajtimin e duhur për kohëzgjatjen e duhur. Trajtimi zgjat me disa muaj, në varësi të formës së Tuberkulozit.

Drejtorisë së Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë **Z.Erol Como** i cili u shpreh se Ministria e Shëndetësisë ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështet të gjitha dispanserite e rrethëve në infrastrukturen e tyre që të jenë të pajisur me aparaturat radiologjike sipas kushteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefqetndroqi.gov.al
info@sushefqetndroqi.gov.al

bashkekohore ku dhe ku egzaminimi radiologjik eshte dhe nje nga komponentet kryesor per vendosjen e diagnoses se TB.

Shefja e Labororit te References **Dr.SHk Silva Tafaj** u shpreh ne lidhje me rrjetin laboratorik te gjithe dipanserive te cilet kryejne egzaminimin e sputumit direkt dhe per rritjen e kontrollit te cilesise ne laboratore. Aju u shpreh se se shpejti jemi ne pritje te nje aparati GEN Expert i cili jo vetem qe konfirmon diagnozen e TB Brenda 2 oreve, por dhe tregon nese pacienti eshte ose jo rezistence ngaj medikamenteve TB ,Kjo do te rrit zbulimin e rasteve ne kohen e duhur dhe do te ulet dhe perhapja e TB pasi pacienti do te diagnostikohet shuem shpejt dhe do te filloje mjekimin me heret .

Shefja e Dispanserise **Dr.Entela Nako** u shpreh se Tirana mbulon nje pjese te konsiderueshme te menaxhimit te rasteve me TB per shkaak se dhe nr i rasteve tashme prej disa viteve eshte rritur si pasoje e levizjes mekanike te populates. Fokusi kryesor i tyre eshte ne diagnostikimin sa me te shpejt te semundjes ,ne kontrollin e famijlareve te tyre dhe personeve te tjere te kontaktit si dhe ne kontrollin e marrjes se mjekimit deri ne fund te muajti te mjekimit .

Pavarsisht se rezultati i mjekimit eshte i mire ne kemi shume pune per te kryer dhe te jemi gjithmone te gatshem pasi semundja e TB eshte semundje qe perhapur me ajer dhe do kujdes te vecante dhe mjekim korrekt .

Dr,Donika Mema Bardhi u shpreh mbi gjendjen aktuale te nr te rasteve me TB ne vendin tone. Ne jemi ne vend me incidence te ulet , por ne duhet qe te zbatojme dhe te arrijne te gjitha objektivat e strategjise Kombetare te TB te cilat jane :

1. Vazhdimin e zbatimit të strategjisë DOTS me një cilësi më të lartë dhe në përmirësim të vazhdueshëm;
2. Adresimin e nevojave të popullatave vulnerabël dhe të varfëra, MDR-TB dhe TB-HIV;
3. Uljen e infeksionit të TB-së;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefqetndroqi.gov.al
info@sushefqetndroqi.gov.al

4. Të kontribuojë në forcimin e Shërbimit Shëndetësor mbështetur në Shërbimin Shëndetësor Parësor;
5. Të angazhojë njerëzit me TB dhe komunitetin nëpërmjet partnership-it si dhe të gjithë furnizuesit shëndetësorë;
6. Të mundësojë dhe të kryejë studime operacionale lokale për TB-në.

Nje support te madh per Programin Kombetar te TB ka qene zyra rajonale e OBSH ne vendin tone si dhe Ministria e Shendetesise jo vetem ne hartimin e strategjise, por dhe ne gjithe komponentet e ketij Programi per semundjen e TB

Ne kete takim foli dhe kryeinfermerja e edukimit shendetesor te TB **Znj ,Merita Jazexhiu** e cila shpjegoi qarte se sa te qete dhe te kujdeshsem duhet te jemi me pacientet e TB qe te arrijme suksesin si per pacientin, por dhe per komunitetin .Gjithashu ajo shpjegoi dhe per testimin per HIV/AIDS te pacienteve me TB ky ne spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi “ kryeht ky testim dhe nese rezulton pozitiv, konfirmohet perseri nga Insituti i Shendetit Publik

Ne kete takim ishte i ftuar dhe perfaqesuesi i komunitetit Rome **Z,Xheladin Dracini** i cili shpreu falenderim te madh per punonjesit e dispanserise per punen e madhe qe kane kryer ne kete komunitet dhe per bashkepunimin e ngushte qe kane midis tyre .

Qëllimi kryesor i Ditës Botërore të TB-së është të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me sëmundjen e TB-së, si dhe të nxjerrë në pah të gjitha përpjekjet për parandalimin dhe kontrollin e TB-së.

Menaxhere e Programit Kombetar te Tuberkulozit

Dr.Donika Bardhi Mema



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefqetndroqi.gov.al
info@sushefqetndroqi.gov.al